



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/62

Datë: 09.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 9 shkurt 2021, merr këtë:

V E N D I M


1. Aprovohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, e cila i bashkangjitet këtij vendimi, për ndarjen e mjeteve finnaciare në vlerën prej pesëqindeshtatëdhjetëenëntëmijë e treqindedyzetepesë euro (579,345.00 €) për mbulimin e shpenzimeve për nevojat emergjente për protezat e Invalidëve të luftës së UÇK-së.
2. Mjetet e parapara sipas pikës një (1) të këtij vendimi merren nga nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me Kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, në xhirollogarinë e ProCredit Bank nr. 1110003683000163.
3. Mjetet e parapara sipas pikës një (1) shfrytëzohen vetëm për qëllimet e specifikuar në kërkesën përkatëse.
4. Për monitorimin e zbatimit të këtij Vendimi, themelohet Komisioni në përbërje nga:
 - 4.1. Përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Kryesues;
 - 4.2. Përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë – anëtar;
 - 4.3. Drejtori i Zyrës për Çështje të Kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së - anëtar;
 - 4.4. Përfaqësues nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së – anëtar.
5. Obligohet Komisioni nga pika katër (4) e këtij Vendimi që të monitorojë shpenzimet e parapara me këtë Vendim, dhe të përgatis Raportin e detajuar për Qeverinë.
6. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Obligohen institucionet përkatëse të ofrojnë zgjidhje të perhershme për Invalidët e Luftës së UÇK-së në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 10/61 të datës 03.02.2021.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Për shkak të gjendjes emergjente të shkaktuar nga COVID-19 dhe për shkak të gjendjes së rëndë dhe problemeve shëndetësore të Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe me qëllim të sigurimit të mbulimit të shpenzimeve për nevojat emergjente për protezat e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, aprovohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së në kuadër të Fondit për Rimëkëmbje Ekonomike, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë